



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Plani i Punës 2021

Dhjetor 2020



©Akademia e Drejtësisë 2021, Të gjitha të drejtat e rezervuara Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Plani i punës është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë
me datën 12.04.2021

Hyrje

Për të siguruar një punë efikase Akademia e Drejtësisë ka përgatitur Planin e Punës për vitin 2021, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe dinamika e arritjes së këtyre objektivave për këtë vit. Qëllimi i këtij plani është të përgatisim një plan menaxhimit të bazuar në kapacitete subjektive dhe teknike që ka Akademia e Drejtësisë duke u bazuar në performancën e deritanishme dhe shfrytëzimit sa më të mirë të kapaciteteve që do të shërbenin në rritjen e rezultateve të punës.

Ky plan i punës është hartuar në pajtim me objektivat strategjike të integruara në Planin Strategjik për vitin 2019-2021 dhe Programin Trajnues Kornizë (2021-2022). Gjithashtu vlejné të përmendet se ky plan do të zbatohet në përputhje të plotë me udhëzimet e parapara për situatën e krijuar pas përhapjes së pandemisë Covid-19.

Në strukturën e planit të punës do të pasqyrohen në hollësi, aktivitete që do të realizohen në kuadër të secilit departament dhe divizion duke përfshirë prioritetin, periudhën kohore dhe veprimet që do të merren për realizimin e këtyre aktiviteteve, njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre si dhe treguesit apo indikatorët që duhet të arrihen nëpërmjet këtyre aktiviteteve.

Për realizimin e Planit të Punës, AD do të përgatit planin e veprimit të punës do të hartohet edhe plani i zbatimit si dhe mekanizimi i monitorimit.

I. SFIDAT NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE PËR VITIN 2020

Objektivat e punës për vitin 2020, në përgjithësi janë realizuar me sukses. Situata e re e paraqitur gjatë këtij viti, e shkaktuar nga pandemia COVID 19, ka qenë sfiduese për procesin e punës për të gjitha institucionet e vendit duke përfshirë edhe Akademinë e Drejtësisë. Duke u bazuar në rekomandimet e OBSH-së dhe institucioneve tjera relevante të Kosovës, të gjitha aktivitetet trajnuese të planifikuara sipas kalendarit trajnues janë pezulluar me qëllim të respektimit të masave anti – Covid. Akademia e Drejtësisë falë angazhimit dhe përkushtimit maksimal të stafit të saj dhe aplikimit të teknologjisë informative, trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët, stafin administrativ dhe për profesionet e lira si dhe trajnimi fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar brenda periudhës minimale tri javore (gjatë mbylljes totale të vendit) ka filluar implementimin e trajnimeve përmes platformave të ndryshme elektronike çofshin ato drejtpërdrejtë apo dhe përmes platformës së mësimin në distancë e-learning.

Procesi i adoptimit të legjislacionit sekondar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë ka përfunduar megjithatë, vazhdon të ketë pengesa në përmbushjen e plotë të mandatit dhe kompetencave të saj konform praktikave me të mira dhe standardeve ndërkombëtare. Me qenë se ligj aktual ka kufizuar nxjerrjen e akteve tjera nenligjore të domsdoshme, e qe mungesa e akteve të tilla nënligjore vazhdone të ndikojë drejtpërdrejt në zbatimin e plotë të funksioneve dhe në arritjen e plote të priturve të institucionit , Akademia e Drejtësisë gjate vitit i ka iniciuar procesin e rishikimit të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë ,me synim fuqizimin dhe kompletimin e infrastrukturës së dosmdoshme ligjore qe do të mundësonte ngritjen e cilësisë së trajnimeve , qartësimin e kompetencave dhe autorizimeve ligjore ne ofrimin e shërbimeve për përfituesit ne përputhje me misionin dhe vizionin e saj.

Andaj ne këtë kontekst , Akademia e Drejtësisë gjatë periudhës raportuese ka qene pjese e nëngrupeve punuese ne procesin e rishikimit funksional te sundimit te ligjit si te udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë . Lidhur me këtë, Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunuar me grupin punues duke ofruar komentet e saj, të cilat synojnë qëndrueshmërinë institucionale, pavarësinë edhe funksionalitetin më të mirë të këtij institucioni. Çdo riorganizim ndryshe i cili do të cenonte këto vlera nuk fuqizon përpjekjet për ndërtimin e një sistemi të pavarur të drejtësisë , të paanshëm dhe profesional. Përkundër procesit për rishikimin funksional, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar aktivitetet dhe angazhimet e saj në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe komunitetit tjetër ligjor në çështjet më sfiduese të sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke ofruar praktikën më të mira dhe standardet evropiane.

Në kuadër të veprimtarisë botuese gjate vitit janë zhvilluar disa manuale dhe doracakë, si është publikuar revista Justicia ,përderisa paqartësia e politikave dhe rregullativës së publikimeve ka pamundësuar punën në zhvillimin dhe

nxjerrjen revistës “Opinio Juris”. Përveç situatës me pandeminë gjate vitit vështirësi te theksuara ka paraqite edhe korniza ligjore e pa përfunduar e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në arritjen me sukses të objektivave strategjike.

Në sektorin e financave janë realizuar të gjitha pagesat me kohë për obligimet që kanë rrjedh gjatë këtij viti, edhe pse ka pasur vështirësi dhe vonesa plani i prokurimit është realizuar në përgjithësi Përkundër rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është realizuar me sukses sepse janë përfshirë gjithë akteret e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Në këtë drejtim janë shteruar gjitha burimet e informacionit përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga dokumentet strategjike të vendit. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti i cili është analizë e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2021 dhe njëkohësisht prezanton procesin dhe metodologjinë si dhe rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces.

Rëndësia e Planit të Punës për vitin 2021

Plani i punës është një dokument i rëndësishëm në të cilin pasqyrohen saktë aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit në funksion të përmbushjes së mandatit të përcaktuar me ligj. Përveç kësaj pasqyron saktë edhe resurset brenda institucionit të cilat duhet të angazhohen edhe hapat e mëtutjeshëm deri në arritjen e rezultateve. Në përmbushjen e këtij plani, Akademia e Drejtësisë vëmendje të veçantë do t’i kushtoj menaxhimit të punës, i cili duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve. Dinamika e punës sipas këtij plani duhet të përcillet në baza javore dhe mujore me qëllim që të mos ketë ngecje në përmbushjen, por në mënyrë sistematike të përcillen të arriturat e përcaktuara në këtë plan.

II. MANDATI I AKADEMISË SË DREJTËSISË

Akademia e Drejtësisë është institucion publik, i pavarur i cili është në funksion të zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionistët e tjerë ligjor. Pra, veprimtaria e saj është e orientuar në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve ligjor në sistemin e drejtësisë përkatësisht sistemin gjyqësor dhe prokurorial me qëllim që funksionin e tyre t’a ushtrojnë në mënyrë profesionale, efikase, të pavarur, dhe që e gëzojnë besimin e publikut. Akademia e Drejtësisë këtë funksion e realizon përmes hartimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe ofrimit të burimeve ligjore në përputhje me nevojat reale për trajnime, të cilat identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave, në të cilin përfshihen të gjithë përfituesit, institucionet relevante si dhe mekanizma tjerë të nevojshëm. Akademia Drejtësisë kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

- **Misioni**

Pra, misioni i Akademisë së Drejtësisë është të orfoj trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

- **Vizioni**

Andaj, vizionin i Akademisë së Drejtësisë është që të shërbejë si institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

1.1 Korniza ligjore e Akademisë së Drejtësisë

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë, Akademia themelohet si institucion publik i pavarur e cila si funksion kryesor ka ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionave tjera të lira përmes zbatimit të trajnimeve dhe zhvillimit të veprimtarisë botuese dhe materialeve tjera ligjore.

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë si dhe aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, dhe atë si në vijim:

- Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 07/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
- Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.

1.2 Organet e Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues si organ më i lartë i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2021 do të fokusohet në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve si në vijim:

- Listën e trajnuesve të përkohshëm
- Standardet për publikim
- Iniciativën për rregullimin e statusit të punësuarve në AD përshtatshmërisht me stafin e gjykatave dhe prokurorive
- Projekt buxhetin e Akademisë së Drejtësisë
- Raporti vjetor për vitin 2020
- Formimin e komisioneve për revistat e AD-së dhe nevojat tjera që dalin për funksionimin më të mirë të AD-së;
- Listën e mentorëve
- Kërkesat e KGK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që sapo emërohen;
- Emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Drejtues dhe organeve tjera
- Programin Trajnues dhe Planit të Punës për vitin 2022 si dhe çështje tjera që dalin gjatë vitit 2021.

Këshilli Programor

Këshilli Programor si organ profesional për vitin 2021 do të angazhohet për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara si dhe për veprimtarinë botuese. Lidhur me këtë do të fokusohet në çështjet si në vijim:

- Rishikimi i listës së trajnuesve dhe rekomandimet për KD
- Rekomandime për Këshillin Drejtues për programet trajnuese
- Rekomandimet për Këshillin Drejtues për veprimtarinë botuese

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë do të fokusohet në prioritet: si në vijim:

- Përfaqësimin e Akademisë në institucione vendore dhe ndërkombëtare;
- Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- Do të siguroj zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues
- propozon projektbuxhetin vjetor të Akademisë;
- Propozon programin e punës dhe programin trajnues të Akademisë;
- Propozon listën e trajnerëve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista do të caktoj trajnuesit për zbatim të programit;
- Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- Propozimin e Projekt Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Akademisë, Projekt Rregulloren

mbi përzgjedhjen e trajnuesve.

Trajnuesit e përhershëm

Trajnuesit e përhershëm janë pjesë e Departamentit të Programit / Zyrës së Programeve Trajnuese të Akademisë së Drejtësisë. Në vitin 2021 trajnuesit e përhershëm do të ligjërojnë me trajnuesit vendorë dhe ndërkombëtarë në trajnimet për gjyqtarë e prokurorë (PTV), për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj (PTF) si dhe profesionistë të tjerë në lëmin e gjyqësisë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Njëkohësisht ata do të hartojnë dhe zbatojnë programe konkrete të trajnimit ku do të jenë të angazhuar si trajnues si dhe do të hartojnë dhe përgatisin materiale, module dhe prezantime që do të përdoren për trajnime në të gjitha programet e AD-së. Trajnuesit e përhershëm në bashkëpunim me ekspertët vendorë, të jashtëm dhe Këshillin Programor të AD-së, do të freskojnë dhe plotësojnë programet trajnuese të AD-së kur paraqitet nevoja.

Trajnuesit e përhershëm në këtë vit do të angazhohen në realizimin e objektivave që derivojnë edhe nga ato të Akademisë së Drejtësisë dhe Departamentit të Programeve / Zyrës së programeve trajnuese si: Në ngritjen e aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve (PTV), gjyqtarëve dhe prokurorëve në Programin Trajnues Fillestar (PTF), bashkëpunëtorëve profesional dhe profesionistëve tjerë në lëmin e gjyqësisë në lëndët ku ligjërojnë ata. Gjithashtu aktivitetet e tyre do të kontribuojnë në realizimin e suksesshëm të programeve të trajnimit duke respektuar afatet e përcaktuara. Trajnuesit e përhershëm gjithashtu do të përgatisin module dhe prezantime në nivelin e kërkuar me aktet e AD-së. Ata po ashtu do të marrin pjesë në hartimin e programeve të trajnimit dhe në veprimtarin hulumtuese-botuese si dhe analiza ligjore për nevojat e Akademisë së Drejtësisë.

1.3 Objektivat strategjike për vitin 2021

Akademia e Drejtësisë do t'i bazon objektiva e planit të punës për vitin 2021 në objektivat strategjike si në vijim:

- Objekti strategjik 1 – Te ju mundësoj gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ dhe profesioneve tjera që në mënyrë efektive dhe profesionale të kryejnë detyrat e tyre përmes trajnimeve të orientuara në punë dhe të bazuar në kompetenca, duke synuar rritjen e besimit të publikut për gjykatat dhe prokurorët
- Objektivi 2 – Lehtëson zhvillimin e hulumtimeve ligjore dhe mundëson botime në fushën ligjore për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial

- Objektivi 3 – Miraton qasja e “përgjegjësisë së përbashkët” ndaj palëve te interesuara për fuqizimin institucional të gjykatave dhe prokurorive duke krijuar programe të trajnimit të koordinuara dhe balancuara për përfituesit në zbatim të politikave të trajnimit
- Objektivi 4 – Mbështet zbatimin e Ti-së moderne për punën ligjore dhe administrative gjyqësorit, duke ofruar trajnime për shkathësitë të rëndësishme vitale me të cilat portalet elektronike brenda gjyqësorit (e – drejtësisë) dhe Akademisë (e- lërnin) mund të përdoren në mënyrë efektive
- Objektivi 5 - Akademia e Drejtësisë siguron ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e burimeve njerëzore, infrastrukturës teknike dhe fondet e mjaftueshme për zbatimin e misionit dhe vizionit
- Objektiva 6 – Akademia e Drejtësisë do të punojë për të përmirësuar bashkëpunimin ndërkombëtar
- Objektiva 7 - Akademia e Drejtësisë gëzon dhe vlerëson besimin publik dhe rrit ndjeshmërinë e publikut

III. PROGRAMET TRAJNUESE DHE AKTIVITET HULUMTUESE DHE BOTUESE TE AKADEMISË SE DREJTËSISË

1. Programi i trajnimit fillestar (PTF)

Bazuar në Programin Trajnues Kornizë (2021-2022) dhe Programi i Trajnimi Fillestar për gjeneratën e VIII-të, (2020-2021) është miratuar nga Këshilli Drejtues, dhe si rrjedhojë Akademia e Drejtësisë do të jetë e gatshme në përgjigje të kërkesës së KGJK-së për fillimin e trajnimit. Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial sa i përket procesit të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.

Programi i Trajnimit Fillestar për vitin 2021 do të fokusohet në objektivat specifike si në vijim:

- Zbatimin e trajnimit fillestar që reflekton kompetencat profesionale dhe interdisciplinare;
- Zbatimin e trajnimit praktik në gjykata dhe prokurori nën 10bikëqyrjen e mentorit
- Zbatimin e trajnimeve praktike në institucione tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore;

- Zhvillimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në fushën hulumtuese dhe qasjen në burime ligjore.

1.1 Zbatimi i trajnimit fillestar që reflekton kompetencat profesionale dhe interdisciplinare

Ky program përfshinë trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, duke përfshirë edhe Acuis Communautaire, KEDNJ dhe aktet e tjera ndërkombëtare si dhe kompetencën interdisciplinare.

Në kuadër të këtij programi do të realizohen trajnimet nga 6 modulet trajnuese:

- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- E drejta civile administrative dhe ekonomike
- Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare
- Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese

Në përmbajtje të këtyre moduleve trajnuese janë gjithësejt 47 nën module trajnuese të cilat përfshijnë 283 sesione trajnuese.

1.2 Zbatimi i trajnimit praktik në gjykata dhe prokurori nën mbikqyrjen e mentorit

Programi i Trajnimit Fillestar do të angazhohet në zbatimin dhe mbikqyrjen e trajnimit praktik në gjykata dhe prokurori duke angazhuar mentorë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve me përvojë të cilët do të mentorojnë pjesën praktike të programit.

Bazuar në strukturën e programit pjesa praktike do të realizohet në 3 ditë të javës për 12 muaj sa zgjat ky program.

1.3 Zbatimi i trajnimeve praktike në institucione tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore

Në kuadër të trajnimeve praktike gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar do të ndjekin edhe trajnime në institucione tjera jashtë gjyqësore, puna e të cilave është e ndërlidhur me punën e gjyqësorit. Institucionet e planifikuara për këtë vit janë:

- Gjykata Kushtetuese
- Avokati i Popullit
- Policia e Kosovës

- Shërbimi Korrektues
- Shërbimi Sprovues
- Dogana e Kosovës
- Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale
- Instituti i Mjekësisë ligjore

1.4 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në fushën hulumtuese dhe qasjen në burime ligjore

Programi i Trajnimit Fillestar do të angazhohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në fushën e hulumtimeve. Kjo komponentë do të realizohet përmes rasteve praktike gjatë trajnimit dhe punimeve hulumtuese të cilat janë pjesë obligative e programit fillestar.

2. Programi i trajnimit të vazhdueshëm (PTV)

Bazuar në Programin Trajnues për vitin 2021, Planit Strategjik 2019-2021 përkatësisht objektivit strategjik nën 1, trajnimet e vazhdueshme do të orientohen në trajtimin e infrastruktures ligjore duke përfshirë ndryshimet legjislative dhe rekomandimet nga strategjitë e ndryshme vendore dhe mekanizmat ndërkombëtarë në fushën e gjyqësorit. Gjithashtu vëmendje të veçantë do të kenë edhe përmbushja e masave dhe obligimeve që dalin nga rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit.

Në këtë drejtim për vitin 2021, trajnimet e vazhdueshme do të fokusohen në objektivat specifike si në vijim:

- Zbatimi i trajnimeve cilësore të specializuara sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore;
- Zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile
- Zbatimin e trajnimeve e detyrueshme të përcaktuara nga KGJK dhe KPK;
- Zbatimin e programe trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion.

2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnime të specializuara sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore

Në kuadrin e trajnimeve të specializuara do të realizohen 5 trajnime në çështjet si në vijim:

- PST për kërkimin kibernetik

- PST për Shpëlarjen e parave dhe hetimin financiar
- PST për Prokurimin publik
- PST për Krimin e organizuar dhe korrupsionin
- PST për Ekstremizmin, radikalizmin dhe terrorizmin

Të gjitha këto trajnime do të realizohen në dy-tri sesione me kohëzgjatje në total 28 ditë trajnimi në të cilat synohet të përfshihen gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti për krime të rënda dhe departamentit special. Varësisht nga tematika që trajtohet do të përfshihen edhe profile tjera të pjesëmarrësve duke përfshirë, zyrtarë policor hetues si dhe zyrtarë nga institucione tjera që kanë fushëveprim luftimin e veprave përkatëse.

2.2 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Programi i trajnimeve të vazhdueshme do të jetë i angazhuar në zhvillimin dhe zbatimin e tranimeve cilësore duke ofruar ekspertizën më profesionale në të gjitha fushat e trajnimit, metodologjinë trajnuese si dhe praktikën më të mira të trajnimit gjyqësor. Sipas përmbajtjes do të realizohen trajnime nga drejtësia penale, civile, drejtësia për të mitur, të drejtësia administrative, tregtare – komerciale, financiare, mbrojtën e mjedisit, bashkëpunimin ndërkombëtar, KEDNJ, E Drejta Ndërkombëtare dhe e Bashkimi Evropian (BE), E drejta kushtetuese si dhe Kundërvajtëse. Po ashtu edhe trajnimet nga kompetenca ndërdisiplinore me theks te shkrimi dhe arsyetimi gjyqësor, etika profesionale, gjuhët e huaja, komunikimi, menaxhimi i stresit, shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim, teknologjia informative si dhe menaxhimi i rasteve dhe fusha të tjera specifike.

Bazuar në përmbajtjen e këtij programi do të realizohen gjithësejt rreth 70 trajnime që në total do jenë rreth 120 ditë trajnimi.

2.3 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile

Programi i trajnimeve të vazhdueshme do të angazhohet në zbatimin e tryezave për çështje të sfidave sa i përket politikave ndëshkimore, sequestrimit dhe konfiskimit, në çështjet familjare me theks te dhuna në familje, për çështje nga procedura përmbarrimore, kontestimore, pronësore dhe çështje tjera sfiduese në procesin e bërjes së drejtësisë me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore.

Pas tryezave planifikohet nxjerrja e konkluzioneve të cilat do të kenë impakt në hartimin e doracakëve, udhëzuesve dhe formave tjera të materialeve ligjore të cilat do të lehtësojnë procesin e punës në gjykata dhe prokurori.

2.4 Zbatimin e trajnimeve e detyrueshme të përcaktuara nga KGJK dhe KPK

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme do të organizohen trajnimet e detyrueshme që janë rezultat i obligimeve ligjore dhe akteve nën ligjore si dhe kërkesave nga KGJK dhe KPK, kryetarëve të gjykatave, kryeprokurorëve, për shkak të ndryshimeve legjislative, dhe vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Bazuar në Rregulloren për trajnime të KGJK-së dhe KPK-së, AD ka përfshirë në kurikulën e saj etiken profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët. Ky trajnim dhe trajnimet tjera të detyrueshme sipas KGJK-së dhe KPK-së të cilat derivojnë nga vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ofrohen në koordinim me këto institucione.

2.5 Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion

Në pajtim me mandatin e AD-së parashihen edhe trajnimet për avancim në detyrë, gjyqtarët dhe prokurorët që kanë kaluar nga niveli më i ulët në nivel më të lartë në gjykatë dhe prokurori, nga një departament në departamentin tjetër dhe si dhe nga niveli i prokurorisë së apelit në zyrën e kryeprokurorit të Shtetit. Këto trajnime kanë për qëllim ofrimin e programeve orientuese-aftësuese, për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe avancimin e tyre profesional, lidhur me përgjegjësitë e reja të funksionit dhe nivelit në të cilin kanë kaluar. Duke u bazuar në Programin Trajnues Kornize (2021-2022) kurikula trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar do të përfshijë module nga kompetenca profesionale dhe ndërdisiplinore duke i njoftuar me specifikat e detyrave të reja me të cilat janë ngarkuar, hierarkinë institucionale, praktikat më të mira të shënuara dhe zhvillimin e shkathtësitë të veçanta për kompetencat që i përkasin funksionit të ri.

3. Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive

Në Programin Trajnues Kornize për vitin 2021-2022 janë paraparë edhe trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive. Akademia e Drejtësisë do të organizojë trajnime specifike për këtë kategori përfituese, në pajtim me politikat dhe standardet e aplikueshme si dhe kërkesat ligjore, por gjithmonë duke ju referuar problemit praktik në ofrimin e ekspertizës për këtë fushë e cila është sfidues për AD-në.

3.1 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë faktor kyç në përmirësimin e efikasitetit të punës së gjykatave dhe prokurorive dhe sipas Ligjit për

Akademina e Drejtësisë janë kategori e re përfituese e trajnimeve.

Bazuar në kompetencat që janë të përcaktuara me Ligjin për Akademina e Drejtësisë dhe Planin Strategjik 2019-2021, përkatësisht objektivin strategjik nën 1, Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në objektivat si në vijim:

- Zhvillimin e kurrikulës së veçantë trajnuese fillestare për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor;
- Zbatimin e trajnimeve sipas aplikimit për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe stafi tjetër profesional;
- Zbatimin e kurrikulës trajnuese të planifikuara sipas programit trajnues për vitin 2021 për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

3.1.1 Zhvillimi i kurrikulës së veçantë trajnuese fillestare për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor

Akademia e Drejtësisë do të zhvillojë një kurrikulë trajnuese fillestare, të veçantë trajnimi për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor duke përfshirë aspekte nga e drejta materiale dhe procedurale në shqyrtimin paraprak të çështjeve dhe përgatitjen e shqyrtimeve gjyqësore. Fokusi thelbësor do të jetë veçanërisht në hartimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore pasi që të gjitha vlerësimet e deri tanishme identifikojnë mangësitë e bashkëpunëtorëve dhe zyrtarëve në këtë fushë.

3.1.2 Zbatimi i trajnimeve sipas aplikimit për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe stafi tjetër profesional

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zbatimin e vendimit të Këshillit Drejtues në bazë të cilit bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit tjetër profesional iu lejohet aplikimi në trajnime të vazhdueshme së bashku me gjyqtarët dhe prokurorët. Lidhur me këtë do të hartohet një plan veprimi për zbatimin e këtyre trajnimeve.

3.1.3 Zbatimi i kurrikulës trajnuese të planifikuara sipas programit trajnues për vitin 2021 për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Në kuadrin e trajnimeve të planifikuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial do të realizohen 9 trajnime, përkatësisht 11 ditë trajnimi të cilat përfshijnë module trajnuese nga kompetenca profesionale dhe interdiscipinare.

3.2 Trajnimet për avokat shtetërorë, avokatë dhe profesionet tjera të lira

Në vazhden e bashkëpunimit me institucionet e profesioneve të lira, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të ofrojë trajnime për këto kategori. Numri i sesioneve trajnuese do të përcaktohet sipas përmbajtjes së tematikës që do të kërkohet nga këto institucione. Bazuar në kërkesat dhe nevojat për trajnime të avokatëve shtetëror, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të mundësoj pjesëmarrjen e tyre në trajnimet e vazhdueshme bashkë me gjyqtarët dhe prokurorët.

3.3 Trajnim për Trajnues (TiT)

Bazuar në Programin Kornizë 2021-2022, Akademia e Drejtësisë për vitin 2021 do të realizojë afërsisht 5 trajnime të trajnuesve të cilat do të jenë rezultat i bashkëpunimit me projektet me donatorë. Trajnimet do të përqëndrohen në trajtimin e këtyre fushave: drejtësinë komerciale, parandalimin e torturës, shpëlarjen e parave, sekuestrimin dhe konfiskimin si dhe lirinë e shprehjes. Numri i sesioneve dhe kohëzgjatja e tyre do të përcaktohet varësisht nga përmbajtja që do të kenë trajnimet përkatëse.

Përveq aktiviteteve të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë synon që gjatë vitit 2021-2022 me partnerët ndërkombëtarë të angazhohet edhe në hartimin e Programit të Përhershëm për Trajnues dhe mentorë. Ky program do të fokusohet në ngritjen e aftësive dhe strategjive të mësimdhënies si dhe avancimin e teknikave për aplikimin e metodologjisë moderne trajnuese. Vëmendje e posaçme do ti kushtohet edhe ndryshimeve në infrastrukturën ligjore sa i përket standardeve dhe mënyrës se përzgjedhjes se trajnuesve dhe mentorëve.

3.4 Mësimi në distancë (e-learning)

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2021 do të zhvilloj kurse të reja trajnuese të cilat do të jenë të çashtme në të dy gjuhët (Shqip dhe Serbisht). Tematika që do të ofrojnë këto kurse janë: sekustrimi dhe konfiskimi, shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim, mbrojtja e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat dhe dizajni industrial, kompensimi i viktimave të krimit si dhe kursi për përdorimin e SMIL.

Gjithashtu, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Kosovë, planifikon të inkorporojë disa nga kurset e platformës HELP në platformën e saj E-learning me qëllim të begatimit të përmbajtjes së saj me module cilësore dhe profesionale.

4. Hulumtimet dhe botimet

Përveç aspektit të trajnimeve, hulumtimet dhe botimet në fushën juridike janë kontribuese dhe faktorë kyç në zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe komunitetin tjetër ligjor.

Bazuar në kompetencat që janë të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe Planin Strategjik 2019-2021, përkatësisht objektivin strategjik nën 2, programi i PHP-së për vitin 2021 do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 2.1 Zbatimin e procesit për vlerësim të nevojave trajnuese;*
- 2.2 Zhvillimin e veprimtarisë botuese;*
- 2.3 Zhvillimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, dhe bazës së të dhënave, përmirësimi i analizave dhe statistikave;*
- 2.4 Ofrimin e burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së.*

4.1 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese

Procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese do të filloj krahas zbatimit të programit trajnues 2021 duke zbatuar mekanizmat për vlerësim dhe duke përcjellë zhvillimet në gjyqësor gjatë gjithë vitit. Në procesin për vlerësimin e nevojave trajnuese do të përfshihen gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke përfshirë edhe trajnuesit e AD-së si dhe analiza dhe hulumtimi i dokumenteve dhe raporteve qoftë vendore ashtu edhe ndërkombëtare të cilat kanë impakt për sundimin e ligjit. Analizat dhe hulumtimet do të jenë të fokusuar në drejtim të zhvillimit të programeve trajnuese në harmoni me standardet evropiane, për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe për proceset euro integruese. Në këtë proces do të angazhohen përves njësisë së PHP-së edhe përgjegjësit e programeve trajnuese, për të kontribuar me rekomandimet nga pyetëtorët por edhe në zhvillimin e aktiviteteve tjera në funksion të vlerësimit të nevojave trajnuese.

4.2 Zhvillimi i veprimtarisë botuese

Akademia e Drejtësisë përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime gjatë vitit 2021 do të angazhohet në krijimin e infrastrukturës duke i përcaktuar qartë kriteret e saj për publikime dhe njëkohësisht në krijimin e trupave profesionale për vlerësim varësisht prej fushave me interes për publikim. Kësaj çështje duhet kushtuar vëmendje domosdoshmërisht për të funksionalizuar vazhdimin dhe me nxjerrjen e revistave *Opinio Juris* dhe *Justicia*. Në kuadrin e revistave do të fokusohet në përmirësimin e cilësisë së punimeve veçanërisht duke senzibilizuar aspektin krahasimor dhe praktikën gjyqësore përmes kriterve dhe standardeve për publikim si dhe sipas mundësive buxhetore edhe përmes veglave që

detektojnë plaxhiaturën. Në këtë vështrim përmes opinioneve dhe pikëpamjeve të shprehura përmes punimeve në revistat Justicia dhe Opinio Juris si dhe formave tjera të publikimit që kanë në fokus praktikën gjyqësore, synohet të ofrohen perspektiva të reja dhe praktika më të mira për çështje të ndryshme ligjore.

Vëmendje të veçantë do të kenë edhe zhvillimi i moduleve trajnuese bazuar në kriteret dhe standardet që do të përcaktohen për publikim, zhvillimi i doracakëve për praktikën gjyqësore në fusha të ndryshme si dhe publikimi i buletinit mujor i cili do të prezantojë veprimtarinë e AD-së dhe aktivitetet e tjera të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

4.3 Zhvillimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, dhe bazës së të dhënave, përmirësimi i analizave dhe statistikave

Në kuadrin e bibliotekës ligjore do të fokusohet në ofrimin e resurseve që ofron biblioteka për përfituesit e saj varësisht prej kërkesave si dhe në menaxhimin dhe përditësimin e data bazave të saj. Vëmendje të veçantë do ti kushtohet abonimit në data baza përmes vazhdimit të anëtarësimit në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike.

Në kuadrin e statistikave do të vazhdohet me integrimin dhe përditësimin e të dhënave lidhur me aktivitetet trajnuese duke shërbyer si burim kryesor efikas i informatave për nevoja të raportimit institucional qoftë në KGJK, KPK për gjyqtarë, prokurorë dhe përfituesit tjerë sipas ligjit ashtu edhe për institucione tjera dhe organizma ndërkombëtarë që monitorojnë sistemin e drejtësisë.

4.4 Ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së

Biblioteka ligjore e Akademisë së Drejtësisë do të vazhdojë të jetë në shërbim të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit sepse do t'iu mundësojë qasje në burimet ligjore që ofron kjo bibliotekë si në formë të shtypur ashtu edhe në atë elektronike. Kjo bibliotekë do të operojë përmes dy platformave elektronike, sistemit informativ të bibliotekës që njihet si sistemi KOHA dhe platformës së E PRINTIT që ndryshe quhet E Biblioteka apo edhe biblioteka elektronike.

Biblioteka përmban afërsisht rreth 1600 tituj që përfshinë enciklopedi, fjalorë, gazeta zyrtare, ligje komentare, libra akademikë që trajtojnë çështje ligjore, doracakë të ndryshëm, artikuj nga revista të ndryshme etj, të cilat do të jenë në shfrytëzim të përdoruesve të bibliotekës sipas kërkesave për studim dhe hulumtim të përfituesve të AD-së.

5. Bashkëpunimi me akterët relevantë

Në kuadrin e përgjegjësisë së përbashkët për fuqizimin institucional të gjykatave dhe prokurorive, Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në këto objektiva specifike:

5.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës;

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në bashkëpunimin e mëtejshëm ndërinstitucional veçanërisht me KGJK dhe KPK, Gjykata dhe Prokurori me fokus në zbatimin e programeve trajnuese dhe përfshirjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial veçanërisht në trajnimet e detyrueshme e gjithashtu edhe në trajnimet që ata shfaqin interes sipas kalendarit trajnues për ti ndjekur. Gjithashtu në zhvillimin e kurrikulave trajnuese sipas nevojave dhe kërkesave të këtyre institucioneve dhe në shkëmbimin e informatave dhe çështjeve tjera në interes të përbashkët.

5.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Përveç institucioneve të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë për të fuqizuar edhe më tej bashkëpunimin ndërinstitucional gjatë vitit 2020 ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione të sistemit të drejtësisë e po ashtu edhe me organizata që kanë fokus sundimin e ligjit. Marrëveshjet e arritura janë me institucionet si në vijim: Akademinë e Sigurisë Publike, Shoqatën e Sigurimeve, Qendrën e trajnimeve dhe burimeve për avokim, Odën e përmbauesve Privat, Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës “Isa Buletini”, Chechi & Company Consulting, Initiative for Justice and Equality (INJECT) Këto marrëveshje bashkëpunimi do të konkretizohen me programe të trajnimit të koordinuara dhe të balancuara për kategoritë përkatëse, në shkëmbimin e informatave të dala nga trajnimet, shkëmbimin e informacioneve dhe materialeve profesionale dhe akademike, zhvillimin e kurrikulave trajnuese dhe formave tjera.

5.3 Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim të planifikimit dhe zbatimit të politikave euro integruese, Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat vendore në zbatimin e masave dhe aktiviteteve në përmbushje të agjendës evropiane. Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në zbatimin e masave të përcaktuara për vitin 2021 të cilat

reflektojnë kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe mekanizmave tjerë euro integruar. Në këtë drejtim me mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë, Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunuar duke marrë përgjegjësi në zbatimin e masave për vitin 2021 të cilat kanë qëllim avancimin e sistemit të drejtësisë me theks në luftimin e shpëlarjes së parave, hetimeve financiare, korrupsionit dhe veprave tjera që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Në këtë kuadër do të vazhdojë të bashkëpunojë përmes raporteve periodike dhe të dhënave tjera që kërkohen nga mekanizmat përkatës.

6. Divizioni i TI-së

Përdorimi i teknologjisë informative në zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera përmes teknologjisë informative do të jetë një ndër objektivat kryesore në fushën e teknologjisë informative. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike që posedon AD-së është një proces i vazhdueshëm i cili kërkon dhe ofron siguri dhe qëndrueshmëri për këto pajisje. Në situatën aktuale më shumë se asnjëherë më parë, Akademia e Drejtësisë do të jetë e angazhuar në zhvillimin e teknologjisë informative meqenëse aktivitetet e AD-së do të realizohen përmes platformave të mësimin online.

Divizioni i TI do të vazhdojë në ofrimin e përkrahjes së shërbimeve të TIK-ut për përdoruesit e TI-së në realizimin e objektivave të AD-së. Prioritet do të jetë avancimi i infrastrukturës së TI-së, ngritja e cilësisë të trajnimeve përmes shërbimeve të TIK-ut dhe aplikimi i Office 365 tek të gjithë përdoruesit.

7. Departamenti i administratës dhe financave (DAF)

Bazuar në Programin Kornizë dhe Planin strategjik të AD-së, Departamenti për administratë dhe financa do të fokusohet në zbatimin e politikave zhvillimore brenda kompetencës së vet në mbështetje të Programit trajnues dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Në kuadrin e njërive përmes të cilave operon ky departament do të fokusohet në këto objektiva specifike:

- 5.1 Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore;*
- 5.2 Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në pajtim me rregullat ligjore në fuqi;*
- 5.3 Planifikimin e prokurimit dhe menaxhimin e drejtë të kontratave si dhe*
- 5.4 Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021.*

7.1 Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Akademia e Drejtësisë aktualisht ka 32 pozita të miratuara, të cilat kontribuojnë në realizimin efikas të procesit të punës dhe në arritjen e objektivave të institucionit. Akademia e Drejtësisë do të jetë e përkushtuar në ofrimin e kushteve më të mira të punës, në rritjen e potencialit të tyre dhe vlerësimin real. Do të angazhohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve aktuale njerëzore dhe në këtë drejtim do të mundësoj stafit ndjekjen e trajnimeve të ndryshme përmes IKAP por jo vetëm, duke siguruar programe adekuat trajnimi, me qëllim të përfitimit të praktikave më të mira dhe mundësive të reja për zhvillim profesional.

7.2 Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit në pajtim me rregullat ligjore në fuqi

Burim kryesor financiar i Akademisë së Drejtësisë është buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet e ndryshme. Departamenti për Administratë dhe Financa do të angazhohet në përgatitjen e kërkesave buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara duke vlerësuar koston reale për të gjitha aktivitetet e përfshira në buxhetim.

Planifikimit buxhetor do ti paraprijnë takimet dhe vlerësimet brenda njësie organizative të cilat luajnë rol të rëndësishëm dhe vendimtar në këtë proces. Planifikimi i mirë dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet duke respektuar rregullat ligjore në fuqi, të cilat sigurojnë realizimin e planit dhe programit të Akademisë.

7.3 Planifikimi i prokurimit dhe menaxhimi i drejtë i kontratave

Bazuar në Ligjin për prokurimin publik, aktivitetet e prokurimit dhe lidhjen e kontratave për Akademinë i realizon Agjencia Qendrore e Prokurimit. Me këtë ligj ka ndryshuar edhe procesi i realizimit të aktiviteteve të prokurimit. Megjithatë, në fushën e prokurimit, Akademia do të angazhohet në planet për menaxhimin e kontratave dhe zbatimin e tyre në harmoni me legjislacionin në fuqi.

7.4 Ofrimi i shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021

Në kuadër të shërbimeve të përgjithshme përfshihen të gjitha aktivitetet që mbështesin realizimin e funksioneve kryesore të AD-së, si: shfrytëzimi i teknologjisë informative, përkthimi, infrastruktura, furnizimet, transporti, mirëmbajtja, sistemi elektronik i furnizimeve, klasifikimi dhe arkivimi i dokumenteve.

8. Bashkëpunimi me ndërkombëtar

Akademia e Drejtësisë është e angazhuar edhe më tej në bashkëpunimin ndërkombëtarë veçanërisht, në avancimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.

Në këtë drejtim gjatë vitit 2021, Akademia synon të jetë në projekte të përbashkëta ndërkombëtare për zhvillim të gjyqësorit e po ashtu edhe nismave të ndryshme rajonale e më gjerë të cilat kanë mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për ndërtimin e një sistemi gjyqësor profesional.

Akademia do të mundësojë trajnuesve dhe veçanërisht përfituesve të saj pjesëmarrjen në forume, konferenca dhe punëtori të ndryshme të cilat kanë në fokus avancimin e trajnimit gjyqësor si dhe sundimin e ligjit.

Gjatë vitit 2021 do të bashkëpunoj veçanërisht me OPDAT, USAID , KE, BE, EJTN, EUKOJUST, JUFREX, PECK III, SAEK, UNDP, GIZ, IRZ , CILC , si dhe me institucionet për trajnime gjyqësore regjionale dhe atyre ndërkombëtare.

Në kuadër të bashkëpunimit me këta mekanizma do të realizohen trajnime dhe aktivitete tjera në fushën e luftimit të korrupsionit, hetimeve financiare, mbrojtjes së të drejtave të njeriut me theks te neni 10 i KEDNJ-së, drejtësinë komerciale si dhe fushave tjera.

9. Marrëdhënie me publikun

Akademia e Drejtësisë është institucion i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë sepse kontribuon në fuqizimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe kontribuon për të pasur një sistem gjyqësor të pavarur, efikas dhe që gëzon besimin e publikut. Bazuar në këtë parim edhe për veten e saj është kujdesur që të ndërtojë mekanizma që i kontribuojnë marrëdhënies me publikun Në këtë drejtim, Akademia vazhdon të fuqizoj edhe më tej besimin e publikut duke bërë transparente veprimtarinë dhe aktivitetet e saj përmes portalit dhe web faqes. Edhe gjatë vitit 2021 do të jetë e përkushtuar edhe më tej që ti bëjë publike gjitha aktivitetet e rëndësishme dhe proceset tjera qoftë përmes njoftimeve publike, shpalljeve dhe formave tjera.

10. Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës së AD-së

Për zbatimin e Planit të Punës për vitin 2021, do të përcaktohen qartë prioritetet e Akademisë dhe aktivitetet kryesore duke paraparë veprimet konkrete, afati

kohorë i realizimit, indikatorët kryesor si dhe rezultatet e punës. Akademia e Drejtësisë do të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial duke përditësuar këtë plan varësisht nga kërkesat që mund të dalin si pasojë e ndryshimeve legjislative apo kërkesave tjera nga autoritete relevante. Mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Punës, bëhet përmes procesit të monitorimit i cili realizohet në baza tre mujore. Ky proces mbikëqyrë përbushjen e indikatorëve si dhe sfidat dhe menaxhimin e rreziqeve.

Plani i Veprimit për Zbatimin e Planit të Punës

Objektivat e përgjithshme	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Aktiviteti -Veprimi	Afati kohor	Indikator/Rezuлтati
1. Aftësimi i gjyqtareve dhe prokurorëve te sapoemëruar (Realizimi i Programit për Trajnim Fillestar)	1.1 Ofrimi trajnimeve për gjyqtarët që do të emërohen, gjenerata VIII	PTF	Organizimi i Trajnimeve ¹ sipas Doracakut per Trajnim te AD -se.	Shkurt - Dhjetor	Numri i sesioneve/ditëve të trajnimit për gjyqtarët e sapo emëruar Raporti përfundimtar i përbushjes
	1.2 Ofrimi trajnimeve për prokurorë që do të emërohen gjenerata IX	PTF	Organizimi i Trajnimeve sipas Doracakut per Trajnim te AD -se.	Maj- Dhjetor	Numri i sesioneve/ditëve të trajnimit për prokurorët e sapo emëruar Raporti përfundimtar i përbushjes
2. Avancimi i vazhdueshëm i shkathtësive dhe ekspertizës ne kompetencat profesionale dhe interdisciplinare per gjyqtare , prokurorë dhe stafin administrativ. (Realizimi i Trajnimeve te	2.1 Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe interdisciplinare për gjyqtar dhe prokurorë	Programi i trajnimeve të vazhdueshme (PTV)	Organizimi i Trajnimeve sipas Doracakut per Trajnim te AD -se.	Janar – Korrik Shtator- Dhjetor	# Gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar
	2.2 Ofrimi i trajnimeve të specializuara	Programi i trajnimeve të vazhdueshme (PTV)	Organizimi i Trajnimeve sipas Doracakut per Trajnim te AD -se.	Janar – Korrik Shtator- Dhjetor	# Gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar
	2.3 Ofrimi i trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarë dhe prokuror	Programi i trajnimeve të vazhdueshme (PTV)	Hartimi i kalendarit trajnues për trajnime të detyrueshme në koordinim me KGJK dhe KPK, si dhe caktimi i trajnuesve dhe zhvillimi i materialeve	Mars – Korrik Shtator- Dhjetor	Gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar

¹ Doracaku per Trajnues përmban te gjitha protokollet që ndërlidhen me përgatitjen, organizmit te trajnimeve, duke përfshi hartimin e kalendarit, zhvillimin dhe zbatimin e moduleve te trajnimit , metodologjinë trajnuese si dhe si dhe vlerësimin e trajnimeve.

Vazhdueshme-Programi i Trajnimeve Kornize 2020-2022)			trajnuese		
	2.4 Ofrimi i trajnimeve për avancim	Programi i trajnimeve të vazhduesh me (PTV)	Hartimi i kalendarit trajnues në koordinim me KGJK dhe KPK, si dhe caktimi i trajnuesve dhe zhvillimi i materialeve trajnuese	Mars - Dhjetor	Gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar të trajnuar
	2.5 Unifikimi i praktikës gjyqësore në çështjet e ndërlidhura me fushën penale dhe civile	Programi i trajnimeve të vazhduesh me (PTV)	Në koordinim me gjykatat dhe prokuroritë, organizimi dhe zhvillimi i tryezat nga fushat e përcaktuara në Programin trajnues kornizë	Mars – Korrik Shtator-Dhjetor	Raporti me Konkluzionet e dalura nga tryezat. # Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëmarrës në tryeza.
	2.6 Ofrimi i trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive	Programi i trajnimeve të vazhduesh me (PTV)	Në koordinim me KGJK, KPK, kryetarët dhe kryeprokurorët si dhe me donatorët në caktimin e kalendarit trajnues si dhe zhvillimin e materialeve trajnuese	Maj-Dhjetor	Kryetarët e gjykatave, dhe Kryeprokurorët e prokurorive, gjyqtarët mbikëqyrës, udhëheqës të departamenteve dhe divizioneve të trajnuar
	2.7 Ofrimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Programi i trajnimeve të vazhduesh me (PTV)	Organizimi i Trajnimeve sipas Doracaktit për Trajnime të AD -se.	Mars - Dhjetor	Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial i trajnuar
	2.8 Organizimi i trajnimeve për trajnues	Departamenti Programeve	Hartimi i kalendarit trajnues si dhe zhvillimi i materialeve trajnuese	Shkurt - Dhjetor	Numri i TIT dhe numri i Trajnuesve të trajnuar
	2.9 Organizimi i trajnimeve nga distanca	Departamenti Programeve	Njoftimi i pjesëmarrësve për kurset online dhe hartimi i kalendarit dhe materialeve trajnuese	Janar - Dhjetor	Gjyqtarë, prokurorë si dhe përfitues tjerë sipas ligjit të trajnuar
	3. Rritja e cilësisë së programeve trajnuese	PHP	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga mekanizmat e zhvilluar	Janar tetor	Mekanizmat e vlerësimit të nevojave të përditësuar

	3.2 Rishikimi dhe përditësimi i metodologjisë trajnuese	PHP	Përditësimi i doracakut për trajner dhe zhvillimi i protokolleve tjera për mësim në distancë	Janar-tetor	Doracakut i përditësuar dhe i publikuar
4. Ngritja e aftësive dhe kapaciteteve analitike hulumtuese dhe veprimtaria botuese	4.1 Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve analitike hulumtuese për gjyqtarë dhe prokurorë në PTF	PHP&PTF	Mbledhja e punimeve Redaktimi dhe vlerësimi punimeve, lektorimi si dhe publikimi	Mars-Dhjetor	Revistat Justicia publikuara
	4.2 Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve analitike hulumtuese e profesionistëve të ndryshëm ligjor	PHP	Mbledhja e punimeve Redaktimi dhe vlerësimi punimeve, lekturimi si dhe publikimi	Mars-Dhjetor	Revistat Opinio Juris e publikuar
	4.3 Zhvillimi dokumenteve periodike, moduleve, programeve dhe buletinit të Akademisë	PHP	Përgatitja teknike e materialit për shtyp Monitorimi i procesit të dizajnit dhe të shtypjes	Janar-Dhjetor	Modulet trajnuese të publikuara Raporti vjetor 2020 i publikuar Programi trajnues 2022 i publikuar Plani i punës 2022 i publikuar Buletini i publikuar Dokumente tjera ligjore të publikuara
	4.4 Hulumtime dhe analiza për zbatim të programit trajnues	PHP	Përgatitja e raporteve për mekanizma të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë	Mars-Dhjetor	Raportet e hartuara

	4.5 Ofrimi i koleksioneve të bibliotekës dhe publikimi i materialeve të reja ligjore në bibliotekën elektronike	PHP	Integrimi i materialit në data bazën e bibliotekës elektronike dhe njoftimi i përfituesve me koleksionet e reja	Janar-Dhjetor	Raporti për numrin e përdoruesve
5 Rishikimi dhe zhvillimi Programit Trajnues të AD-së për vitin 2021-2022	5.1 Përditësimi i Programit Trajnues për vitin 2022	Departamenti i Programit të trajnimeve dhe ekspertëve	Mbledhja dhe përpunimi i temave që dalin si rezultat i vlerësimit të nevojave trajnuese gjatë vitit 2021	Mars-Tetor	Drafti i përditësuar
	5.2 Rishikimi i programit të trajnimeve për prokurorët që do të emërohen gjenerata IX	Departamenti i Programit të trajnimeve dhe ekspertëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Propozimi i draft programit trajnues ▪ Përcaktimi i kalendarit ▪ Koordinimi me trajnuesit dhe mentorët ▪ Përditësimi i moduleve trajnuese 	Shkurt - Prill	Drafti i hartuar
	5.6 Rishikimi i sistemit të vlerësimit të trajnimeve	PTV&PT F	Hartimi i formularëve para dhe pas trajnimit	Mars - Dhjetor	Formularët e hartuar
6. Planifikimi strategjik i AD-së	6.1 Rishikim i zbatimit të planit strategjik 2019-2021	AD	Monitorimi dhe zbatimi i planit strategjik 2019-2021	Janar - dhjetor	Plani strategjik i monitoruar dhe zbatuar
	6.2 Procesi i hartimit të planit strategjik 2022-2025	AD	Punëtori për hartimin e planit të punës	Nëntor	Plani strategjik i hartuar dhe i miratuar
7. Avancimi i bashkëpunimit dhe partneritetit me donatore dhe institucionet tjera	7.1 Zbatimi i memorandumeve të bashkëpunimit	AD	Vlerësimi Memorandumete bashkëpunimit	Janar - dhjetor	Marrëveshjet e nënshkruara/zbatuara
	7.2 Zbatimi i projektit me donator	AD	Koordinimi për zbatimin e projekteve	Janar - dhjetor	Raportet e punës
8. Udhëheqja dhe mbikëqyrja e punës së	8.1 Menaxhimi financiar dhe sistemi i	DAF	Vlerësimi i nevojave Përgatitja e KASH-it 2022-2022	Mars – prill	KASH-i dhe buxheti i hartuar

Akademisë	kontrollit		Përgatitja e buxhetit 2022 dhe vlerësimet 2023-2024 Regjistrimi në BDMS dhe PIP sistem	Maj - Korrik	
	8.2. Ngritja e shkathtësive profesionale të burimeve njerëzore	DAF	Planifikimi i personelit duke përfshirë edhe pozitave e reja të nevojshme Zhvillimi i procedurave të rekrutimit	Janar - Dhjetor	Plani i hartuar Planifikimi i realizuar
	8.3 Zhvillimi i prokurimit sipas nevojave të programeve	DAF	Planifikimi i prokurimit menaxhimi i kontratave sipas dhe identifikimi i nevojave Përgatitja e planit vjetor Përgatitja raporteve të prokurimi	Janar-Dhjetor	Planifikimi dhe menaxhimi i realizuar
	8.4 Shërbimet e përgjithshme	DAF dhe TI	Avancimi dhe zbatimi i teknologjisë informative Rishikimi i funksionalitetit të web faqes dhe bazës së të dhënave	Janar Dhjetor	Plani i realizuar
9. Përmirësimi infrastrukturës dhe ambientit të AD	9.1 Monitorimi i finalizimit të punëve ndërtimore në objektin e AD dhe zhvillimi i planit të mobilizimit për zhvendosje	AD ,MF , EU dhe donatorët	Koordinim i aktiviteteve me MPB për ndërtimin e ndërtesës së AD-së dhe identifikimi i asetëve dhe plani i mobilizimit	Janar dhjetor	Plani i mobilizimit të zhvendosjes në ndërtesën e AD

11. Sfidat dhe rreziqet

Realizimi i këtij plani përmban edhe sfida dhe rreziqe, ndër të cilat theksojmë:

- Akademia e Drejtësisë është pjesë e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit që ndikon drejtpërdrejtë në punën e AD-së meqë si proces ende nuk ka përfunduar.
- Rishikimi i legjislacionit për Akademinë e Drejtësisë
- Procesi i transferimit në ndërtesën e re të AD-së paralelisht me zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021.
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit.
- Procesi i qartësimit të statusit të AD-së përshtatshëmrisht me statusin e të punësuarve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial;
- Fuqizimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet

përgjegjëse të sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Ky bashkëpunim duhet të jetë i ndërsjellë, dhe të intensifikohet pasi që përfitues të trajnimeve janë gjyqtarët, prokurorët, stafi administrativ gjyqësor e prokurorial si dhe profesionistët tjerë;

- Zhvillimet në gjyqësor dhe ndryshimet legislative kanë ndikim drejtpërdrejt në punën e Akademisë, dhe paraqesin sfidë të vazhdueshme në realizimin me sukses të objektivave strategjike.
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- Forma e re e realizimit të trajnimeve (virtuale), për shkak të pandemisë (mos aplikimi i pajisjeve që vërteton prezencën apo mos prezencën në trajnim);
- Pjesëmarrja jo aktive në trajnimet virtuale;
- Mungesa e trajnuesve të profilizuar;
- Zhvillimi i kurrikulës trajnuese fillestare për bashkëpunëtorët profesional si dhe profesionistët tjerë ligjor;
- Mos shfrytëzimi i mjaftueshëm i resurseve të bibliotekës nga ana e përfituesve të AD-së;
- Mungesa e literaturës dhe burimeve tjera për trajnime në gjuhën shqipe;
- Hvillimi programit të përhershëm për trajnues;
- Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të trajnimit veçanërisht të metodologjisë së trajnimit të bazuar në raste.

Akademia e Drejtësisë do të hartoj një regjistër të veçantë ku do të parashihen të gjitha rreziqet e mundshme, shkalla e rrezikut, personat përgjegjës për adresimin e këtyre rreziqeve si dhe specifika tjera siç përcaktohet me të gjitha standardet relevante për monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve

12. Përfundimi

Plani i punës hartohet me qëllim të përmbushjes së mandatit ligjor të Akademisë së Drejtësisë në mënyrën sa më funksionale duke përfshirë edhe menaxhimin më të mirë të punës së Departamentit të Programit dhe Departamentit të Administratës dhe Financave në funksion të këtij qëllimi. Plani është dizajnuar në atë formë duke iu përshtatur rrethanave të reja ku janë përcaktuar në detaje realizimi i aktiviteteve të programeve si dhe njësive përgjegjëse që operojnë në kuadër të Akademisë së Drejtësisë. Stafi i Akademisë do të angazhohet në përmbushjen e këtij plani duke i marrë në konsideratë veprimet dhe afatet e përcaktuara për çdo aktivitetet të paraparë.

